

VENDIM
Nr.20, datë 28.3.2006

PËR VENDOSJEN E GJOBËS NDAJ KESH SHA

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 64 pika 1 germa “ç” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit nr.11, datë 23.2.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për dhënien e licencave për aktivitetin e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, importit dhe eksportit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a., Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.3.2006, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe i Marrëdhënieve me Publikun, lidhur me mospërbushjen nga ana e të licencuarit KESH sh.a. të kushteve (përkatësisht pika 3.7 dhe pika 4.5) të vendosura në licencën e furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.56, datë 12.10.2005.

VENDOSI:

1. Të dënojnë me gjobë të licencuarin KESH sh.a. në shumën prej 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për mospërbushjen e kushteve të përcaktuara në pikat 3.7 dhe 4.5 të licencës së furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.56, datë 12.10.2005.

2. Departamenti i Administrimit, Financës dhe Burimeve Njerëzore, si dhe Departamenti i Licencave dhe i Monitorimit të marrë masa për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema